

**VENDIM**  
**Nr. 205, datë 4.12.2020**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERDY ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “KALIS” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1958 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 127/1 prot., datë 2.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1232 prot., datë 27.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Kalis, me vendndodhje në përrroin e Shmilit, Kuterman, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Shoqëria “Erdy Energy” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 11.1.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB) me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), si dhe ka lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën e koncesionit nr. 1945 rep., nr. 885/3 kol., datë 4.9.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Kalis’, me kapacitet prodhues 1958 kw, në ujërat rrjedhëse të lumit të Shmilit, degë e Lumit Shkumbin, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”.

- Nga analiza e dokumentacionit të aplikimit për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Erdy Energy” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, dhe pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;
- leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.
- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd, do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Shoqëria, pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullësor publik të sipërfaqes së përcaktuar më sipër, duhet ta depozitojë atë në ERE.
- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor, do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë në ERE të rifreskuar.
- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në

rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria do të përcjellë në ERE licencën për drejtuesin teknik-elektrik dhe strukturën e ndërtimit të saj në *hard copy*.

- Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “*Erdy Energy*” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kalis”, me kapacitet të instaluar 1958 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**